

## STATUTI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “CYBER SENTRY SOLUTION ALBANIA” SHPK

Sot, më datë 29.06.2022, në Tiranë në mbështetje të Ligjit nr. nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe me parashikimet, e Ligjit nr. 55/2018, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Aktit të Themelimit të shoqërisë “Cyber Sentry Solution Albania” SHPK, veprimtaria e saj do të organizohet dhe drejtohet sipas kushteve të këtij Statuti:

#### **Neni 1**

##### **Emërtimi**

Shoqëria do të ketë emrin “Cyber Sentry Solution Albania” SHPK, dhe do të njihet me shkurtimein “C.S.S.A.” Shpk.

#### **Neni 2**

##### **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin dhe legjislacionin shqiptar.

#### **Neni 3**

##### **Forma ligjore**

Shoqëria është me përgjegjësi të kufizuar, por mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **Neni 4**

##### **Kohëzgjatja e veprimtarisë**

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i pacaktuar. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

#### **Neni 5**

##### **Selia**



5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga "Rr. Andrea Kushi, Ish-Fusha e Aviacionit, Rezidenca Turdiu, Kulla A, kati 7, Apartamenti 8, Tiranë, Shqipëri.

5.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 6**

### **Emblema dhe vula**

Të gjithë dokumentet e Shoqërisë duhet të përmbajnë emblemen dhe vulën e saj. Shoqëria në korrespondencën dhe vulën e saj mund të përdorë edhe emrin në gjuhën angleze "Cyber Sentry Solution Albania – C.S.SA."

## **Neni 7**

### **Objekti i veprimtarisë**

7.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- viii. Konsulencë në fushën e sigurisë së Informacionit, Penetration Testing dhe Forensic. Importim, eksportim dhe tregtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit për perpunimin e të dhënave të të gjitha llojeve si: hardware, software, networking dhe të gjithë periferikeve të tyre
- ix. Montim aparaturash të sipër përmendura, parametrizim, konfigurim. Dizajn software-i, përcaktimi i kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitektures dhe projektimi i detajuar i sistemit software; Zhvillim dhe mirëmbajtje të sistemeve software, ku përfshihet programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponenteve, suport i sistemit si një tërësi komponentesh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e Zgjidhjes Informatike.
- x. Testim software, testimi i funksionaliteteve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software. Dizajn dhe zhvillim të sistemeve të komunikimit, analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja. Trajnime dhe Kurse të Formimit Profesional. Vlerësim Rrisku dhe Menaxhimi i Incidenteve, Shërbime të organizimit të aktiviteteve, dhënia me qera platformash të teknologjisë së informacionit, shërbime informatike me qera, riparime dhe mirëmbajtje të pajisjeve kompjuterike.
- xi. Auditim të Sistemeve të Sigurisë së Informacionit, Auditim të Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit, Auditim të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, Auditim të Cësive të Menaxhimit të Informacionit. Import-Eksport,



- prodhim, tregeti me shumice dhe pakice, dhenie me qera, me leasing, e te gjitha produkteve te fushave: IT-se dhe telekomunikacionit, sisteme te integruara, sisteme te sigurise dhe alarmit, sisteme audio dhe ndricim profesional, sisteme audio/video konferencash dhe perkthimi, sisteme te rradhes, Sherbime konsulence, suportu, implementimi, trajnimi dhe edukimi ne te gjitha fushat e mesiperme.
- xii. Konceptim, projektim, modelim, prodhim, implementim, shitje apo dhenie me qera, te softwareve, websiteve, aplikacioneve, platformave ERP dhe CRM etj , si edhe sherbime te adoptimit dhe pershtatjes se tyre. Sherbimeve te internetit si webhosting, domain, email, data transmitting WAN, LAN, FO, VOIP, IPTV. Konceptim, dizenjim, brandim, prodhim dhe shitje te produkteve te fushes se promocionit dhe grafikes.
- xiii. Shitje, Servis dhe Mirembajtje dhe pjese kembimi te ndryshme per Printera, Fotokopje, Skanera, Videoprojektor, Barcode Scanner, POS, Kompjuter, Laptop, Servera, Storage, Pajisje rrjeti, Monitor, Ups, Bateri, Invertera, Rack, Sisteme Sigurie, Sisteme aksesit, Sisteme Antizjarri, Home Automation etj. Shitje dhe servis pjesesh konsumi per Printer Fotokopje Skaner, etj. Shitje Bateri per UPS, Inverter, etj.
- xiv. Kryerjen e çdo lloj aktiviteti tjetër që ka lidhje të drejtëpërdrejtë ose jo me përmbushjen e objektit të sipërpermendur të shoqërisë.

7.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet në përputhje me kërkesat ligjore.

## **Neni 8**

### **Kapitali themeltar**

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1000 (një mijë) lekë.
- 8.2 Kapitali i Shoqërisë do të ndahet në 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë. Ortaku i Vetëm zotëron përkatësisht:
- Alban Ademaj zotëron 100 % (njëqind) për qind të të gjithë kapitalit;
- 8.3 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer nga ortakët e shoqërisë.

## **Neni 9**

### **Transferimi i pjesëve të kapitalit**

- 9.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme më rrugë të trashëgueshme, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.





9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme tek të tretët, vetëm pas miratimit nga shumica e ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.

#### **Neni 10**

##### **Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit**

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar.

#### **Neni 11**

##### **Asambleja e Ortakëve**

11.1 Asambleja e Ortakëve përbëhet nga zotëruesit e pjesëve të kapitalit. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që zotëron.

11.2 Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë ose të cilësuar sipas rastit dhe kërkesave ligjore.

#### **Neni 12**

##### **Administratori**

12.1 Shoqëria ka një Administrator i cili do të jetë Alban Ademaj, shtetas shqiptar, lindur në Kukës, më 29 prill 1990, mbajtës i letërnjoftimit nr. 034073870, dhe nr. personal J00429099C, banues në Tiranë, në Rr. Ish-Fusha e Aviacionit, Rezidenca Turdiu, kati 7, Apartamenti 8, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare.

12.2 Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua njeh shprehimisht ortakëve.

12.3 Administratori emërohet, zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të ortakëve që përfaqësojnë më tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.



### **Neni 13**

#### **Kontrolli financiar**

Shoqëria mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të autorizuar për kryerjen e kontrollit financiar të veprimtarisë së saj.

### **Neni 14**

#### **Viti financiar**

14.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të çdo viti.

14.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 Dhjetor 2023.

### **Neni 15**

#### **Dividendi**

Shoqëria do t'i shpërndajë ortakëve të saj të gjithë fitimet që mund të arrihen pasi të ketë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe detyrimet për mbajtjen e rezervave të domosdoshme dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm.

### **Neni 16**

#### **Likuidimi**

Likuidimi i Shoqërisë vendoset nga Asambleja e Ortakëve në përputhje me kërkesat ligjore.

### **Neni 17**

#### **Dispozita mbyllëse**

Ky Statut hartohet në 4 (katër) ekzemplarë në gjuhën shqipe më fuqi të njëjtë ligjore.

**ORTAKU I VETËM:**

**Alban Ademaj**

